

Arian Permeti




PROKUROR NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË RRETHIT
GJYQËSOR TIRANË

Deklaratat e analizuar:

7 Deklarata të analizuar

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2016)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016



Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me
datë 31.12.2016 është rritur 106.1 herë

+ 3,502,101 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete
në Bankë

21,893,552

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Likuiditete
në Cash

17,781,660

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e
Luajtshme

400,000

1,050,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Pasuritë e
Paluajtshme

1,700,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2016

Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2006-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga nga funksioni	4,498,658	10.5%
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	4,431,720	10.3%
Të ardhura nga Qira	4,169,586	9.7%
Likuiditete nga trashëgimia e prindërve	26,660,000	62.2%
Të ardhura të tjera	3,089,875	7.2%
Total	42,849,839	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 7 vite rezultoi:

Pa Probleme



Subjekti Arian Permeti ka një shkeputje gjatë deklarimit nga viti 2005-2012. Në deklaratën fillestare të rikthimit në detyrë në vitin 2013 listohen 34 prona (apartamente, garazh, dyqane dhe sipërfaqe trualli) në Durrës dhe Tiranë, me sipërfaqe totale 11,875m² për të cilat nuk jepet vlerë aseti, të përfituara nga trashëgimia familjare pas vdekjes së nënës, 1/3 pjesë takuese. Gjithashtu subjekti deklaron të ketë përfitur nga trashëgimia asete në llogari bankare vlerë 9,500,000 lekë dhe në gjendje cash 2,700,000 ALL dhe 88,500 euro. Gjithashtu dhe bashkëshortja e subjektit deklaron apartament banimi me vlerë 1,700,000 lekë të blerë me të ardhurat e prindërve.

Në vitin 2016 përfiton nga trashëgimia e babait 1/2 pjesë të tij në prona të paluajtshme në Tiranë dhe Durrës.

Gjendja Cash me datë 31.12.2016 është 17,781,660 lekë, ndërkohë që sipas nenit 4/1 të ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, kufiri i lejuar për t' u mbajtur Cash është 1,500,000 lekë.